



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.12.2018, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE
"SPORT MARKETING" SHA NË PRISHTINË

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing" SHA në Prishtinë.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 130.415.37 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së përgjithshme, 22/616/16306, mjete nga të hyrat vetanake.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është dhënia e ndihmës, të cilën Komuna e Prishtinës ia ndan NPL - së për funksionalizimin e Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmi.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-422/01-0291309/18, më 11.12.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>

